

Titulli i lëndës: Gjuhë shqipe 2

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Gjuhë shqipe 2
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri II
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	5
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass. dr. Kadire Binaj – Ejupi
Të dhënat kontaktuese:	kadire.binaj@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Në lëndën Gjuhë shqipe 2 do të trajtohet struktura sintaksore e gjuhës shqipe. Në këtë kurs studentët do të njihen me konceptet themelore të sintaksës. Ata do të njihen me konceptin e sintagmave (duke përfshirë llojet dhe kriteret e klasifikimit të tyre), dhe të fjalisë (të thjeshtë e të përbërë). Sintagmat e caktuara, varësisht nga relacionet që krijojnë me elementet e tjera të fjalisë, kryejnë funksione të caktuara sintaksore. Analiza funksionale e fjalisë është pjesë e rëndësishme e këtij kursi. Gjithashtu, në kuadër të këtij kursi do të trajtohen edhe llojet e fjalive sipas qëllimit të thënies, sipas modalitetit dhe sipas strukturës dhe llojet e klauzave përbërëse të fjalisë së përbërë, qofshin ato me marrëdhënie barazie ose varësie ndërmjet vete.</p>

Qëllimet e lëndës:

Qëllimi i këtij kursi është që studentët ta njohin strukturën sintaksore të shqipes- t'i dallojnë njësitë sintaksore, të arrijnë të bëjnë analizë sintaksore të shqipes dhe të mund ta krahasojnë më tej strukturën e shqipes me atë të gjermanishtes.

Rezultatet e pritshme të nxënies:

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje:

- T'i dallojë njësitë sintaksore përbërëse të fjalisë, qoftë ajo e thjeshtë apo e përbërë;
- T'i identifikojë llojet e sintagmave dhe të bëjë analizë funksionale të fjalisë;
- T'i dallojë fjalitë e thjeshta nga të përbërat dhe të dallojë llojet e klauzave përbërëse të fjalisë së përbërë;
- T'i njohë llojet e fjalive sipas qëllimit të thënies, sipas modalitetit e sipas strukturës.
- Të bëjë analizë sintaksore duke e krahasuar strukturën e shqipes me atë të gjermanishtes.
- Të dallojë raportet e marrëdhëniet sintaksore

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2 (90 min)	15	22.5
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2 (90 min)	15	22.5
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar			
Konsultime me mësimdhënësin	15 min	15	2.25
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	1	15	15
Detyra të shtëpisë	1	13	13
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	4	5	20
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	3	3	9
Projektet, prezantimet, etj.	10 min	13	1.30
Totali			135.8 orë:25=5.4 5 ECTS
Metodat e mësimdhënies:	<p>Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve praktike. Gjatë orëve të ligjëratave studentëve do t'u ofrohet baza teorike relevante për këtë kurs, ndërsa gjatë orëve të ushtrimeve ata do ta zbatojnë dijen teorike për të bërë analiza të caktuara të sistemit sintaksor të shqipes.</p> <p>Ligjëratat do të organizohen në mënyrë interaktive: duke diskutuar për tema e probleme të caktuara me studentët pas leximit të pjesës teorike nga ta. Gjatë ushtrimeve mësimdhënësia do të jetë e orientuar nga studentët, ndërsa mësimdhënësi do ta orientojë rrjedhën e orës dhe do t'i diskutojë e sqarojë konceptet e problemet që janë të paqarta për studentët. Gjatë orëve të ushtrimeve studentët, gjithashtu, do t'i prezantojnë detyrat e shtëpisë të cilat do t'i diskutojnë me mësimdhënësin e kolegët.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i parë: 45%</p> <p>Vlerësimi i dytë: 45%</p> <p>Prezenca dhe pjesëmarrja aktive 10%</p> <p>Gjithsej: 100 %</p>		

Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Niko Dako, Elona Biba, Ali Jashari, Flutura Çitaku, <i>Gramatika e gjuhës shqipe 2</i>, Prishtinë, 2014 - ASHSH, <i>Gramatika e gjuhës shqipe II</i>, Tiranë, 2002
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - K. Binaj, <i>Modelet strukturore të fjalive në gjuhë shqipe</i>, Prishtinë, 2021, ZeroPrint - Turano, Koleci, <i>Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes</i>, SHBLU, Tiranë, 2011 - T. Kelmendi: <i>Studime sintaksore</i>, Prishtinë, 2008. - Thoma Dhima, <i>Gjuha shqipe – Sintaksa</i>, Tiranë, 2005 - Bahri Beci, <i>Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë</i>, Tiranë, 2004 - Bahri Beci, <i>Gramatika e gjuhës shqipe-për mësimdhënësit e gjuhës shqipe Prishtinë</i>, 1998 - M. Çeliku, M. Karapinjolli, R. Stringa: <i>Gramatikapraktike e gjuhës shqipe</i>, Tiranë, 2004.

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Prezantimi i silabusit. Njësitë gramatikore dhe konceptet gramatikore të sintaksës.
Java 2:	Tipat e fjalive të thjeshta në gjuhën shqipe
Java 3:	Sintagma – kriteret e klasifikimit
Java 4:	Kryefjala dhe kallëzuesi
Java 5:	Plotësit kallëzuesorë dhe kundrinorët
Java 6:	Rrethorët dhe përcaktorët
Java 7:	Gjymtyrët homogjene dhe të veçuara
Java 8:	Testi i parë semestror
Java 9:	Fjalitë e përbëra dhe mjetet gjuhësore të ndërtimit të saj
Java 10:	Fjalitë e përbëra bashkërenditëse
Java 11:	Fjalitë e përbëra nënrenditëse ftilluese (komplementuese)
Java 12:	Fjalitë e përbëra përcaktore
Java 13:	Fjalitë e përbëra rrethore

Java 14:	Fjalitë asidentike dhe ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë
Java 15:	Testi i dytë semestror

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar t'i vijojnë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Nuk lejohen më shumë se tri mungesa gjatë semestrit. Detyrat që dalin nga këto orë mësimi janë të obligueshme dhe pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të studentit. Plagjiatura dhe kopjimi në provime dhe punimet e tjera me shkrim janë të dënueshme. Në rastet e tilla studenti u nënshtrohet masave disiplinore, siç parashihet me rregulloret e UP-së. Sjellja e mësimitdhënësit dhe e studentëve bazohet në kodin e mirësjelljes dhe të etikës në kuadër të UP-së.